



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 88, datë 21.05.2025

PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË
ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “RAIFFEISEN INVEST-SHOQËRI
ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, të Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Peter Zilinek, zj. Elona Llaci dhe zj. Alketa Emini si anëtarë të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “Raiffeisen INVEST-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a., për një mandat 3 vjeçar, deri më 31.03.2028.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI